

**“ÇËSHËTJA E KOSOVËS NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO – JUGOSLLAVE  
GJATË VITEVE 1945 – 1948”**

**TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I SHKENCËS NË HISTORI TË KOHËS SË RE  
NGA  
SHQIPTRIM LATIFI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI FILOZOFIK**

**DEPARTAMENTI I HISTORISË**

**PRISHTINË**

**MARS, 2024**

## REZYME

### “ÇËSHTJA E KOSOVËS NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO – JUGOSLLAVE GJATË VITEVE 1945 – 1948”

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Mentor Hasani

Kjo temë e diplomës trajton çështjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në vitet 1945-1948 dhe ndikimin e tyre në Kosovë, duke synuar që t'i vihet dritë shumë ngjarjeve që kanë të bëjnë me rolin e Partisë Komuniste Shqiptare në raport me shqiptarët e Kosovës, në periudhën fillestare të qeverisjes së Enver Hoxhës deri në vitin 1948, kur ishte në marrëdhënie të ngushta me Jugosllavinë, e ku të gjitha veprimet e tij ishin në shërbim të politikës jugosllave, duke iu besuar ideologjisë komuniste (marksist-leniniste) e cila besonte në barazinë e popujve, si dhe në çlirimin e popujve nga fashizmi. Kjo periudhë nuk ka zënë hapësirën e nevojshme në historiografinë shqiptare. Enver Hoxha, si çdo personalitet tjetër ka dritë-hijet e tij andaj në këtë punim do të shqyrtohet pozicioni dhe veprimet e tij në këto vite.

#### **Punimi është i ndarë në tre kapituj**

Në kapitullin e parë “*Konteksti historik dhe zhvillimet politike në Kosovës 1941-1945*” do të trajtohen në detaje të gjitha ngjarjet që ndodhën në Kosovë përgjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, si ishte ndarë në zona të pushtimit, si jetonin shqiptarët e Kosovës në këto zona nga tre pushtues të ndryshëm, zhvillimi i veprimtarisë politike të shqiptarëve të kësaj anë gjatë kësaj periudhe, si u gjenden ata përballë zhvillimeve gjeopolitike botërore, ardhja në fuqi e Enver Hoxhës në Shqipëri dhe bashkëpunimi i tij me Partinë Komuniste të Jugosllavisë me në krye

Josip Broz Tito. Më pas do të përfshihen vitet e fundit të Luftës së Dytë Botërore, ku zhvillimet në arenën ndërkombëtare do të përcaktonin të ardhmen e Kosovës, konkretisht triumfin mbi nazizmin dhe përpjekjet e vazhdueshme të komunistëve jugosllavë për të vendosur pushtetin në Kosovë, përgjatë kësaj periudhe do të realizoheshin plane për eliminimin e shqiptarëve të Kosovës nën akuzën për bashkëpunëtorë të nazizmit, masakra e Tivarit mbetet njëra ndër ngjarjet më të rënda në historinë kombëtare, e që i përfshirë në këtë ngjarje ishte edhe shteti i Shqipërisë komuniste në krye me Enver Hoxhën.

Në kapitullin e dytë *“Gjendja në Kosovë pas aneksimit si dhe ndikimi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në të”* do të flitet për jetën e shqiptarëve të Kosovës në Jugosllavi pas aneksimit, me çfarë politike shtetërore u përballën ata, si jetonin e si e zhvilluan veprimtarinë e tyre atdhetare në kushte të ilegalitetit, krijimi i lëvizjeve ilegale të fshehta për t’i bërë ballë politikës shkombëtarizuese të sistemit jugosllav për të parë se çfarë veprime ndërmorrën ato, pozitën kushtetuese të Kosovës në realitetin e ri politik, si dhe elementin kryesor të këtij kapitulli që ka të bëjë me zhvillimet në Shqipërinë si në aspektin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm, në veçanti me shqiptarët e Kosovës në këtë periudhë kur kërkonin bashkimin kombëtar, por edhe intensifikimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë deri në formën kur Shqipëria do të duket si shtet vasal i Titos.

Në kapitullin e tretë *“Pasojat e tensioneve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë”*, në llupën studimore do të përfshihet periudha kur dy shtetet do të përballen me realitetin në teren duke lënë më një anë deklaratat që mbretëronin në vend për vite të rë, duke shënuar fillimin e prishjes së marrëdhënieve mes tyre dhe faktorët që çuan në këtë zhvillim, çka ndikoi që për një moment të shemben marrëdhëniet “vëllazërore” në mes të Hoxhës dhe Titos dhe cili ishte roli i Stalinit në këtë mes. Po ashtu, më tej do të pasqyrohet lufta e brendshme politike në Shqipëri, e do t’i kushtohet rëndësi edhe fazës kur merr fund e gjithë “vëllazëria” mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, si ndryshoi drastikisht tregimi i Enver Hoxhës ndaj Titos me rastin e prishjes së raporteve të Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë, me këtë rast do të fillojë të ndryshojë edhe qasja ndaj Kosovës.